



Republika e Kosovës  
Përmbaues Privat  
Iilir Mulhaxha  
I emëruar për territorin e  
Gjykatës Themelore në Prishtinë  
Rr.Luan Haradinaj nr. H 15/7

P.nr.553/21

Përmbauesi Privat në Prishtinë Iilir Mulhaxha, në lëndën e përmbarmit, sipas propozimit për përmbarim të **Kreditorit**: “Banka Credins Kosovë” SH.A., me seli në adresë: Rr. “UÇK” nr.240 Prishtinë, me numër unik identifikues 811410315, përfaqësuar me autorizim nga Avokat Editon Osmani, kundër **Debitorit**: **1.** Kujtim X Maksuti B.I. me numër unik identifikues 810131665, me adresë: Rr. “Brahim Ademi”, Ferizaj, **2.** Kujtim Maksuti me numër personal 1012025382, me adresë: Rr. “Koshare” Ferizaj, **3.** Sahadete Shumolli me numër personal 1171197771, adresë: Rr. “Koshare” Ferizaj, për borxhin në shumë prej **44,761.94 Euro**, më datë: 05.04.2022, bie këtë:

## K O N K L U Z I O N

**I. CAKTOHET** seanca e parë e ankandit publik verbal për shitjen e paluajtshmërisë të hipotekuara, dhe të evidentuara si ngastrat kadastrale nr.P-72217053-00520-2, lloji i njësisë parcelë vend i quajtur Vojak Ara Bajrushit, lloji i shfrytëzimit aktual i parces: Arë i klases 4, me sipërfaqe të përgjithshme 5579m<sup>2</sup>, Zona Kadastale Koshare, pjesa e pronë 1/1 e cila ngastër evidentohet në emër Kujtim Maksuti me numër personal 1012025382, me adresë: Rr. “Koshare” Ferizaj, të vlerësuara në vlerën prej 167,370.00 €.

**II.** Seanca e parë e ankandit publik verbal, si nën pikën **I.** të këtij konkluzioni mbahet më datë 05.05.2022, në ora 10:00, në zyrën e Përmbauesit Privat në Prishtinë Iilir Mulhaxha, Rr. Luan Haradinaj 15/7 Prishtinë.

**III.** Vlera e paluajtshmërisë, si nën pikën **I.** të këtij konkluzioni është përcaktuar sipas marrëveshjes hipotekare në mes të palëve, si në shkresë të lëndës.

**IV.** Në qoftë se paluajtshmëria nuk shitet në seancën e parë, Përmbauesi Privat e cakton seancën e dytë brenda afatit prej **15** (pesëmbëdhjetë) deri në **30** (tridhjetë) ditë. Në këtë seancë paluajtshmëria nuk mund të shitet për çmimin më të ulët se **1/3** (një e treta) e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë.

**V.** Në ankand publik mund të marrin pjesë vetëm personat që më parë e kanë depozituar garancionin, e cila shumë duhet të jetë i barabartë me **1/10** (një të dhjetën) e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë, por nuk mund të jetë më e madhe se **5,000.00 €** (pesëmijë Euro). Depozitimim e garancionit të tillë, nuk janë të detyruar ta bëjnë kreditori, e as personat, si në dispozitën e nenit **231** par. **2** i LPP.



Republika e Kosovës  
Përmbaues Privat  
Irir Mulhaxha  
I emëruar për territorin e  
Gjykatës Themelore në Prishtinë  
Rr.Luan Haradinaj nr. H 15/7

**VI.** Në ankand do të shqyrtohen vetëm tri ofertat e ofertuesve më të volitshëm, ku në rast të shitjes së paluajtshmërisë, ofertuesve me oferta më të ulëta se ofertuesi më i favorshëm, u kthehet garancioni i depozituar, pas ankandit. Ofertat më të ulëta se 50% (pesëdhjetë përqind) e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë, nuk do të shqyrtohen.

**VII.** Personi, i cili caktohet blerës i paluajtshmërisë, duhet të depozitojë shumën e tërësishme të çmimit të blerjes, më së largu në afat prej **30** (tridhjetë) ditësh, nga dita e shitjes, pavarësisht nëse çmimi paguhet menjëherë apo me këste. Në qoftë se blerësi nuk e deponon shumën e çmimit blerës, Përmbauesi Privat do ta shpallë të pavleshme shitjen, sipas dispozitës së nenit **239** par. **2** të LPP.

**VIII.** Blerës të paluajtshmërisë nuk mund të jenë personat si në dispozitën e nenit **233** të LPP.

**XIX.** Ky konkluzion do të shpallet në tabelën e Përmbauesit Privat, do t'iu dërgohet palëve në procedurë, organit komunal me të drejtë ligjore të parablerjes, si dhe organit kompetent administrativ të tatimeve.

Pala apo kushdo tjetër që ka interesa pronësore, ka të drejtë që me shpenzime të tij ta publikoj konkluzionin në mjetet e informimit publik dhe t'i njoftojnë personat që merren me ndërmjetësimin në shitblerjen e paluajtshmërive. Këto shpenzime nuk mund t'i ngarkohen debitorit.

**X.** Drejtoritë përkatëse të Komunës janë të obliguara që këtë konkluzion ta vendosin në tabelën përkatëse të Komunës, për shpallje publike të shkresave.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitivin e këtij konkluzioni, bazuar në dispozitat e nenit **3** par. **1** dhe **5**, nenit **217** par. **2**, nenit **220** par. **2**, nenit **223**, **227**, **229**, **230**, **231**, **233**, **234**, **341** par. **1** pika **1.1.** dhe **1.6.** të LPP, lidhur me nenin **199** LPDTS.

Prishtinë  
05.04.2022



**Udhëzim juridik:** Kundër këtij konkluzioni nuk lejohet mjet i veçantë i goditjes.